# Plani Lokal i Veprimit në Mjedis



# FLETE PUNE

# 1

# INFORMACION I PËRGJITHSHËM



**Përkufizime**

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis (PLVM) është dokument i politikës mjedisore vendore që pasqyron përparësitë dhe detyrat në fushën e mjedisit, veprimtaritë e masat që do të ndërmerren për zgjidhjen e tyre, identifikon organet e strukturat që do të angazhohen, secila në linjën e vet, si dhe përllogarit kostot dhe mbështetjen financiare të nevojshme. PLVM hartohet në nivel qarku, rrethi, bashkie e komune. Përgatitja e tij duhet mbështetur në metodën gjithëpërfshirëse ku çdo individ i komunetit të ketë të drejtën e dhënies së kontributit të tij në këtë proces

**Synimet e PLVMve**

Përmes përgatitjes së PLVMsë:

- zhvillohen aftësitë e pushtetit vendor, subjekteve të ndryshme të interesuara për mjedisin dhe gjithë komunitetit.
- nxitet bashkëpunimi midis pushtetit vendor dhe atij qendror, organizatave jofitimprurëse, biznesit dhe subjekteve të tjera mjedisore, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesmarrjen publike në procesin e vendim-marrjes.

**Fazat e PLVMsë**

Procesi i përgatitjes së një PLVMje mund të kryhet në disa mënyra. Pikat e mëposhtëme paraqesin një prej tyre:

- Njohja e procesit dhe hartimi i strategjisë së punës për përgatitjen e PLVMsë.
- Ngritja e grupit (grupeve) të punës



- Hartimi i strategjisë për përfshirjen e publikut
- Përshkrimin e situatës ekzistuese në zonë.
- Përcaktimi afatgjatë i qëllimeve të komunitetit (p.sh krijimi i vizionit dhe realizimi i qëllimeve strategjike të së ardhmes)
- Përcaktimi dhe vlerësimi i problemeve mjedisore lokale.
- Përshkrimi i hollësishëm i nevojave reale (p.sh përcaktimi i qëllimeve specifike dhe veprimeve konkrete prioritare).
- Përshkrimi i hollësishëm i veprimeve të planifikuara.
- Monitorimi i veprimtarive të planifikuara

**Ndërthurja me çështjet e tjera**

PLVM-të janë të lidhura ngushtë me aktivitete të tjera, si programet kombëtare e rajonale të zhvillimit të qëndrueshëm, Axhendën Lokale 21 dhe sistemet për menaxhimin e mjedisit. Shumë prej këtyre programeve kanë metodologji të ngjashme, pasi përdorin qasjen sipas planifikimit strategjik dhe mbështeten në përfshirjen e gjerë të grupeve të interesuara.

Në shtator 2002 në Samitin e Mijëvjeçarit, ku morën pjesë 147 kryetarë shtetesh dhe përfaqësues të 191 shteteve, u miratua deklarta e zhvillimit të mijëvjeçarit, e cila merr në shqyrtim problemet e paqes, sigurisë, zhvillimit, mjedisit, të drejtave të njeriut dhe qeverisjes, për të cilat qeveria shqiptare është e angazhuar ti përmbushë brenda vitit 2015. Përgatitja e PLVMve është një ndër aktivitetet të cilat synojnë të vendosin në zbatim synimet e qeverisë shqiptare të paraqitura në Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

## PLVM në Shqipëri

Në vendin tonë, organet e qeverisjes vendore përfaqësojnë strukturën më të rëndësishme shtetërore për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit që kanë në juridiksion, duke zbatuar përgjegjësitë, të drejtat e detyrat që u jep ligji. Lidhur me mbrojtjen e mjedisit, ato kanë për detyrë:

- të realizojnë zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e mjedisit;
- të hartojnë plane vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe planet e rregullimit të territorit;
- të bëjnë publike programet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit;
- të njoftojnë publikun për gjendjen e mjedisit dhe për veprimtaritë vendore, subjekte të vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit;
- të nxisin e të mbështesin veprimtaritë e organizatave jofitimprurëse për mjedisin, duke tërhequr mendimin e tyre në marrjen e vendimeve për mjedisin; etj.

Roli dhe funksionet e organeve të qeverisjeve vendore për mbrojtjen e mjedisit, detyra konkrete për to në këtë fushë, formulohen edhe në dokumenta shtetërore të detyrueshme për t'u zbatuar siç janë:

- Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedisin,
- Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedisin dhe Shëndetin,
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për ruajtjen e biodiversitetit.
- Strategjia e zhvillimit të pyjeve.
- Strategjia e ujrave, etj.

**Detyrimet ligjore për hartimin e PLMve**
Kërkesa që qeverisjet vendore të hartojnë e zbatojnë Planet Lokale të Veprimit për Mjedisin (PLVM), është e hershme. Përgatitja e PLVM është e detyrueshme për vendet e Europës Qendrore dhe Lindore që kanë filluar procesin e asocimit dhe që synojnë të integrohen në BE. Për vendin tonë, hartimi i këtyre planeve nga qeverisjet vendore është detyrë ligjore, e parashikuar shprehimisht nga neni 73 i ligjit të ri "Për mbrojtjen e mjedisit" 2002.

**Dokumenta të politikave mjedisore vendore të hartuara deri më sot në Shqipëri**

| | |
|---|---|
| Bashkia Tiranë: | 1994, 2001 |
| Bashkia Fier: | 1998-1999 |
| Qarku Dibër: | 1998-1999 |
| Bashkia Pogradec: | 2000-2001 |
| Bashkia Lezhë: | 2002 |




Kërkesat metodike për hartimin e këtyre planeve dhe përvojat e Tiranës, Dibrës, Fierit, Lezhës, Pogradecit, etj, që e kanë realizuar këtë detyrë, janë një bazë më se e mjaftueshme referimi dhe ndihmë konkrete për gjithë organet e qeverisjeve vendore që duan të angazhohen me hartimin e tyre. Si dokumenti bazë lokal nga i cili burojnë veprimtaritë e masat vendore për përdorimin dhe mbrojtjen e mjedisit, PLVM hartohen në nivel qarku, rrethi, bashkie e komune

# 2

# FILLIMI I PUNËS PËR PËRGATITJEN E PLVM



Përgatitja e PLVMsë duhet të bazohet në njohuritë dhe bashkëpunimin ndërmjet aktorëve kryesorë në një komunitet. PLVM të suksesshme sigurojnë përfshirjen në vendim-marrje të personave të prekur nga problemet e mjedisit. Kjo kërkon gjetjen e interesave të ndryshme brenda komunitetit dhe përfshirjen e tyre në procesin e përgatitjes së PLVMsë.
Bashkëpunimi është shumë i rëndësishëm për përgatitjen dhe zbatimin e mëtejshëm të veprimeve të përcaktuara në PLVM. Bashkëpunimi kërkon drejtues të aftë, mbështetjen e organeve vendore dhe një proces të hapur dhe të besueshëm. Ai kërkon shumë punë, durim dhe angazhim. Grupi përgatitës duhet të luajë rol domethënës në modelimin e një plani për investimet e ardhshme mjedisore, të cilat kanë mbështetjen e publikut.

**Ngritja e grupit të punës**

1. Drejtuesi i pushtetit vendor vendos ngritjen e grupit të punës, mbështetur në konsultimin me aktorë të ndryshëm në komunitet.
2. Përbërja e grupit të punës duhet të përmbushë disa kritere:
   - Përfaqësimin sa më i plotë i interesave në komunitet (përfaqësues të pushtetit vendor, OJFve, bisnesit, etj)
   - Përqafësimin i grupeve të ndryshme (gratë, rinia, minoritete, etj)
   - Përfaqësim i përshtatshëm i kapaciteteve intelektuale



# Rast studimor

**Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për qytetin e Lezhës**

Projekti për Planin Lokal të Veprimit në Mjedis për qytetin e Lezhës ishte një proces që zgjati rreth shtatë muaj duke përfshirë të gjithë aktorët potencial të qytetit: Bashkisë, autoriteteve të tjera vendore, 36 specialistë të fushave që kanë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me mjedisin.
Faza fillestare e projektit përfshiu interesin dhe nevojën e qytetit për një Plan Veprimi. Kryetari i Bashkisë Lezhë theksoi se ky Plan Veprimi vjen në një kohë kur Bashkia po e sheh mjedisin si një prioritet, për shkak dhe të burimeve të shumta natyrore që ka rrethi, duke renditur më pas dhe nismat e ndërmarra nga bashkia për përmirësimin e gjendjes mjedisore në këtë rreth.

Për zhvillimin sa më efikas të këtij projekti u zgjodhën 2 koordinatorë lokalë, njëri prej të cilëve përfaqësues i shoqatës jo-fitimprurëse lokale Eko-Integrim Retina Lezhë (EIRLA)

Më pas u krye identifikimi i aktorëve kontribues në proces, caktimi i koordinatorëve lokalë; përgatitja e materialeve informuese për publikun; si dhe ndarja e grupeve të punës.

Më pas u përcaktuan grupet e punës, u organizua trainimi për specialistët lidhur me Planet Lokale të Veprimit në Mjedis dhe u përcaktua në mënyrë të qartë kontributi i secilit grup në çdo fazë të procesit.





**Grupet e punës u ndanë sipas tematikave të mëposhtëme:**

**Lezha dhe mjedisi urban**
Urbanistika, rritja e popullsisë, zënia e truallit, etj

**Mjedisi urban dhe shëndeti**
Administrimi i ujrave, furnizimi me ujë të pijshëm, siguria ushqimore, mbetjet urbane, mbetjet e rrezikshme;

**Mbrojtja e natyrës**
Toka, konvertimi i brigjeve të Drinit, erozioni, shpyllëzimi, gjelbërimi, biodiversiteti, ekosistemet kritike dhe risku;

**Shërbimet urbane**
Burimet e energjisë, informacioni, aspekti tregtar, transporti urban;

**Aktiviteti social-kulturor**
Aktiviteti kulturor dhe artistik, turizmi, sporti, objektet turistike, guidat, agjencitë, muzetë, bibliotekat etj;

**Qeverisja**
Mënyrat e qeverisjes vendore, gjenerimi i të ardhurave (taksat), varfëria dhe ekonomia urbane.

# 3

# VLERËSIMI I BURIMEVE DHE GJENDJES

# VIZIONI I KOMUNITETIT

Mjedisi dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm po hyjnë gjithnjë e më shumë në fjalorin e përditshëm të të gjithëve. Të gjithë po bëhen gjithjnë e më të ndërgjegjshëm mbi rrezikun që po përshkallëzohet dhe që i kanoset mjedisit dhe që vjen si pasojë e keqpërdorimit të pakontrolluar të burimeve natyrore, ndotjeve dhe aktiviteteve të tjera njerëzore me ndikim negativ në mjedis. Pyetja se si duhet të gjejë zbatim në praktikë zhvillimi i qëndrueshëm është në fokus të debateve të shumta. Përvoja e deritanishme ka treguar se mirëqeverisja dhe pjesëmarrja e publikut janë parakushte thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm. Për zbatimin në praktikë të mirëqeverisjes në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm është i nevojshëm një përkushtim i të gjithëve, inforamcione të mundshme për gjithsecilin, përfshirja e publikut dhe përgjegjësia e vendim-marrësve për të mbajtur barazpeshën ndërmjet nevojave të njerëzve dhe domosdoshmërisë për të ruajtur mjedisin për sot dhe për të ardhmen.

Të gjithë së bashku, ne duhet të gjejmë rrugën tonë drejt një ndjeje më të gjerë të përgjegjësisë reciproke. Të gjithë së bashku, ne duhet të ndërtojmë një etikë të re administrimi. Të gjithë së bashku, ne mund dhe duhet të shkruajmë një kapitull të ri dhe shumë shpresëdhënës për natyrën-njeriun-historinë.

## Vlerësimi i burimeve dhe gjendjes mjedisore të zonës

Kjo fazë kërkon vlerësimin e burimeve natyrore të zonës që përfshin rajoni administrativ i bashkisë / komunës.

**Çështjet që mund të merren në shqyrtim janë:**

**1- analiza e zhvillimit ekonomik dhe social**
- tendencat e zhvillimit socio-ekonomik te rajonit
- lidhja me mjedisin;

**2- uji**
- burimet ujore natyrore;
- konsumi i ujit;
- cilësia e ujit të pijshëm;
- ndotësit kryesorë;
- ujrat e zeza dhe mundësia për trajtimin e tyre,
- burimet natyrore për ujitje dhe administrimi i tyre

**3- ajri**
- analiza e faktorëve klimatikë;
- cilësia e ajrit;
- burimet kryesore të ndotjes;

**4- toka**
- përdorimi i tokës dhe mënyra e administrimit;
- përdorimi i pesticideve;
- erozioni;

**5- zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti**
- parqet dhe rezervatet kombëtare
- gjuetia
- përdorimi për qëllime pushimi dhe çlodhjeje

**6- mbeturinat**
- mbeturinat e ngurta dhe administrimi i tyre
- mundësi për zbatimin e ripërdorimit dhe riciklimit

**7- energjia**
- përdorimi i energjisë dhe plotësimi i nevojave
- mundësi për futjen e burimeve të reja të energjisë

## Vizioni i komunitetit

Një vizion komuniteti parashtron një te ardhme të dëshiruar nga të gjithë, brenda mundësive ekzistuese socio-ekonomike dhe mjedisore. Vizioni ndihmon në krijimin e një baze të qëndrueshme për zhvillimin dhe zbatimin e qëllimeve dhe veprimeve mjedisore. Ai shërben si pikënisja për adresimin e çështjeve kryesore në se si të arrihet një komunitet i qëndrueshëm.

Një vizion komuniteti është pamje e asaj që banorët duan për komunitetin e tyre në 10 apo 20 vitet e ardhshme. Ai është një mundësi për të anashkaluar problemet e menjëhershme dhe shikimin përpara në të ardhmen.

**Çështjet që mund të merren në konsideratë në përgatitjen e një vizioni janë:**
- mjedisi natyror;
- përdorimi i tokës dhe struktura demografike;
- pjesëmarrja, udhëheqja dhe larmia shoqërore;
- infrastruktura (rrugët, institucionet mjedisore, parqet, etj);
- potenciali ekonomik;
- shërbimet edukative dhe sociale; dhe
- traditat kulturore.

# Rast Studimor

## Plani Lokal i Veprimit në Mjedis - Bashkia Lezhë

### Karakteristika të përgjithëshme natyrore të rrethit Lezhë

Lezha shtrihet në pjesën veriore të Ultësirës Perëndimore të Shqipërisë dhe karakterizohet nga një diversitet i larmishëm i relievit, klimave e mikroklimave dhe për pasojë të florës, faunës dhe biodiversitetit në përgjithësi. Sasitë e reshjeve vjetore luhaten nga 1050 – 1100 mm, ndërsa vlerat e temperaturës vjetore luhaten nga 14 – 16 $^0$C .

Lezha ka një sipërfaqe prej 47,200 ha prej të cilave 16,781 ha tokë arë, 17,989 ha pyje, 245.2 ha vreshta, pemtari e ullishte, 2,515 ha livadhe, kullota e truall dhe 6,494 ha sipërfaqe ujore, kënetë dhe tokë jobujqësore.

Rrethi i Lezhës ka një popullsi prej 87,491 banorësh nga të cilët rreth 24,000 në qytet ose 28% e saj.

### Problemet më kryesore mjedisore në rajonin e Lezhës

**Shfrytëzimi pa kriter i pyjeve, tendenca degraduese**

38 % e sipërfaqes së përgjithëshme të rrethit (47,867 ha) janë pyje (sa është dhe sip. e tokës bujqësore). Mesatarisht 100 m$^3$ lëndë drusore në vit pas vitit 1991 konstatohen zyrtarisht të prera pa leje dhe 1 ha të përshkuar nga zjarri. Gjithashtu, 600 ha fond pyjor janë të ekspozuar ndaj erozionit...

**Ulja e llojshmërisë biologjike, prishja e habitateve**

Territori me emrin Kunë-Vain-Tale konsiderohej (7/7/1940) **Rezervë Gjuetije Shtetërore**, me konceptin e sotëm konsiderohet zona e parë e mbrojtur e shpallur në vendin tonë. Shkencëtarët e kanë quajtur “Oaz i Ornitologjisë së Mesdheut”, ”Perlë e natyrës Shqiptare, një Privilegj i saj”.

**Erozioni i tokës bujqësore dhe keqadministrimi i saj.**

Përmbytjet si ato të vitit ‘96 deri në 4,500 ha, të ‘97-ës dhe nga kapërderdhja e detit e vitit të kaluar kanë përkeqësuar e dëmtuar rëndë shtresën aktive të tokës në një sipërfaqe të konsiderueshme. Po kështu kanë pësuar një erodim të plotë 3.5 ha tokë bujqësore të komunave Kolsh, Zejmen, Kallmet, Kashnjet si dhe 13 ha fond pyjor në vitet e sipërpërmëndura. Gjithashtu dyfishimi i numrit të të imtave (dhënve e dhive) ka ndikuar në varfërimin e masës vegjetative në taracimet veçanërisht afër zonave urbane duke ndikuar ndjeshëm në erodimin e tyre ndërsa hapësira të konsiderueshme të ekonomisë pyjore të Molungut të dominuara nga shkurreta mbeten të pazëna nga blegtoria etj.



**Zhvillimi i pakontrolluar urban.**

Ndërtimet e shumta të banesave e të objekteve të tjera kryesisht tregtare, rehabilitimet e mjaft banesave, si në qytetin Lezhë, Shëngjin e në disa komuna tregon potenciale të konsiderueshme për t’u zhvilluar. Por, ndërtimet pa kritere të përcaktuara urbane që një numër i konsiderueshëm nuk kanë lejë, po rëndojnë e dëmtojnë infrastrukturën dhe po zbeh mundësitë urbane të zhvillimit të qytetit në të ardhmen.



**Rritja e shkarkimeve dhe e rriskut të ndotjeve**

**a. Shkarkimet në ujë**

**b. Shkarkimet në ajër**

**c. Shkarkimet në tokë**

**Për shkarkimet e mbeturinave urbane qyteti Lezhë rezulton:**

Probleme të administrimit të burimeve natyrore.

Probleme të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

**Vizioni i bashkisë Lezhë**

Bashkia Lezhë – një qëndër urbane që do të harmonizohet e do të mbrojë, e zhvillojë më mirë vlerat natyrore, e cila do të bazohet në : një rrjet tregtar, transport, komunikacion, industri të lehtë e përpunuese, administrim mbetjesh që do të synojnë standarte të larta mjedisore për një jetë më më shumë denjitet e mirëqënie.

# 4

# VLERËSIMI I PROBLEMEVE MJEDISORE



Vlerësimi i çështjes mjedisore përbën profilin mjedisor të komunitetit. Vlerësimi i tyre siguron informacionin se si industritë, pushteti qendror apo vendor dhe individët ndikojnë negativisht mbi mjedisin dhe si duhet ndërhyrë për t'i zvogëluar këto ndikime.

Një proces i suksesshëm për vlerësimin e problemeve mjedisore dhe përcaktimin e masave përmirësuese kërkon mbështetjen e përfaqësuesve të qeverisë, biznesit dhe organizatave jo-fitimprurëse. Publiku bëhet pjesë e këtij procesi përmes ngritjes së komiteteve këshillimore që sjellin informacionin e saktë mbi shqetësimet mjedisore të komunitetit.

Gjatë vlerësimit të çështjeve mjedisore duhet të kihen parasysh që:

- të përcaktohet metodologjia më e përshtashme: si do të sigurohet informacioni, kush do të kryejë vlerësimin, koha dhe vlefshmëria e të dhënave;
- të përcaktohet qëllimi i vlerësimit: llojet e çështjeve që duhen adresuar, sfera gjeografike, e ardhmja përballë çështjeve ekzistuese;
- të përcaktohen dhe karakterizohen kriteret bazë të vlerësimit: ndikimi dhe rreziku mbi shëndetin njerëzor, burimet dhe ndotësit, shkalla e veprimit të këtyre ndikimeve;
- të përcaktohet shkalla e njohjes së gjendjes dhe saktësisë së informacionit




**Shembull**

**Karakterizimi i një problemi mjedisor**

| **Problemi mjedisor** | **Burimi i ndotjes** | **Lloji i ndotësit** | **Ndikimi negativ në shëndetin njerëzor dhe mjedisin natyror** | **Hapësira e ndotur dhe niveli i ndotjes** |
|---|---|---|---|---|
| Ndotja e sipërfaqes ujore | Kafshët, sistemet e infektuara shtëpiake | Azoti, sëmundje-shkaktuesit | Pakësim i oksigjenit të shpërbërë, eleiminim i popullatave të peshkut, rritje e bakterieve dhe pakësim i mundësive rigjeneruese | E gjithë gjatësia e lumit prej 20 km që kalon përmes qendrës së banuar; ndikimi i rëndë në jetën ujore |

PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS

# Rast studimor

## Plani Lokal i Veprimit në Mjedis - Bashkia Lezhë

**LEZHA DHE MJEDISI URBAN**
Urbanistika, rritja e popullsisë, zënia e truallit, etj.
**Problemet e vërejtura**
Ndërtime të paplanifikuara, që nuk respektojnë studimet (blloku A) e që dëmtojnë zonën arkeologjike (vendvarrimi i Skënderbeut, kala etj), zënë vendet publike, në vendet tërheqëse si në anë të lumit Drin e planifikuar për shëtitore si dhe e shpatit të Kalasë, që prishin ekuilibrat urbanë, etj; Asfiksimi urban në 70 % të periferisë nga pikëpamja e zënies së hapësirave për zhvillim të planifikuar për të ardhmen; Mungesa e vendeve të lira për parqe për qytetin, shëtitore etj;



**MJEDISI URBAN DHE SHËNDETI**
Administrimi i ujrave, furnizimi me ujë të pijshëm, siguria ushqimore, mbetjet urbane, mbetjet e rrezikshme.
**Problemet e vërejtura**
Uji i pijshëm në shumë raste i ndotur (treguesit fizik e bakteriologjik); Ujrat e zeza shkarkohen të patrajtuara në lumin Drin si dhe ka dalje të lirë në mjaft raste në mjediset e jashtme të pallateve; Lumi Drin i ndotur nga shkarkimet e ujrave të zeza si dhe mbetjeve të ndryshme urbane dhe rritja e pezullive nga prurjet në rast reshjesh (sidomos nga efektet e erozionit të zhvilluar); Mjedisi tregtar i produkteve blegtorale, bulmetrave etj., rrezikon ndotjen e ushqimeve;

**MBROJTJA E NATYRËS**
Toka, tjetërsimi i brigjeve të Drinit, erozioni, shpyllëzimi, gjelbërimi, biodiversiteti, ekosistemet kritike dhe rreziku.
**Problemet e vërejtura**
Prishja e habitateve dhe varfërimi i biodiversitetit (Lumi Drin e brigjet, shpati i Kalasë, mali Skënderbeg , L. Kodër-Marlekaj etj.); Zhvillimi i erozionit në shpatin e Kalasë, Malin e Shelbumit, është favorizuar nga dëmtimi i masës bimore të tyre; Dëmtimet e habitateve artificiale e natyrale brenda zonës së urbanizuar të qytetit; Prishja e koridoreve ekologjike Drin – Shpati i Kalasë etj; Prishja e habitateve në zonat suburbane dhe varfërimi i biodiversitetit.

**SHËRBIMET URBANE**
Burimet e energjisë**.** Informacioni, aspekti tregtar, transporti urban
**Problemet e vërejtura**
Mungesa e përdorimit të burimeve të tjera të energjisë (era, dielli) dhe mungesa rrugëve të tjera që ulin koston e gazit si burim më i përshtashëm aktual energjie; Rritja e kostos nga përdorimi energjisë elektrike dhe ndikimet direkte e indirekte në mjedis; Ndikimet në mjedisin urban nga rrjeti i amortizuar ajror elektrik e rreziqet për komunitetin; Transporti publik interurban dhe brenda hapësirës urbane të qytetit i papërshtatshëm;

**AKTIVITETI SOCIAL-KULTUROR**
Aktiviteti kulturor e artistik, turizmi, sporti, objektet turistike, guidat, agjencitë, muzetë, bibliotekat etj.
**Problemet e vërejtura**
Papërshtashmëria midis objekteve kulturore e sportive me mjedisin urban të qytetit, mosrespektimi i mjedisit natyror ose i zhvillimit të tyre; Objektet arkeologjike të pasistemuara dhe me mjedise të gjelbërta të papërshtatshme. Mungesa e menaxhimit, (mungesa e infrastrukturës për menaxhimin e tyre); Degradimi i elementeve të objekteve historike të lagjes së vjetër Varosh (shtëpitë monument kulture, rrugët me kalldrëm, etj), si dhe i muzeve etnografikë e historikë, mungesa e harmonizimit dhe respektimit të natyrës përreth.

**QEVERISJA**
Mënyrat e qeverisjes vendore, gjenerimi i të ardhurave (taksat), varfëria dhe ekonomia urbane.
**Problemet e vërejtura**
Mungesa e organeve përgjegjëse ligjore për hartimin e strategjive të zhvillimit; Administrimi i mangët ligjor i territorit urban, (njohja e kthimi i pronave brenda hapësirave urbane); Mungesa e inspektoriatit urban për territorin e bashkisë; Prishjet e mjedisit urban dhe mungesa e policisë bashkiake për ndërhyrjen e menjëhershme; Menaxhimi i mangët i mjedisit urban e i aktiviteteve të tjera për të mbështetur zhvillimet që respektojnë mjedisin, që rehabilitojnë e përmirësojnë atë; Ndërgjegjësimi i pakët i komunitetit për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të përgjegjësive ligjore në këtë drejtim. Mungesa e rrjetit informativ e ndërgjegjësues për mjedisin.

# 5

# IDENTIFIKIMI I AKTIVITETEVE PËRGATITJA PLANIT TË VEPRIMEVE



Përgatitja e Planit të Veprimeve krijon mundësinë këqyrjes së praktikave ekzistuese në komunitet për menaxhimin e mjedisit; identifikimin e aksioneve kryesore dhe vlerësimin e kritereve dhe administrimin e analizave specifike ekonomike, inxhinierike dhe të tipeve të tjera, për të siguruar një bazë për të zgjedhur veprimet e nevojshme për përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Plani i Veprimeve është thelbi i PLVMsë. Ai përmbledh listën e veprimeve prioritare të përcaktuara në bazë të analizës së burimeve natyrore dhe problemeve mjedisore të shqyrtuara në fazat e mëparshme të PLVMsë. Së bashku me to, në Planin e Veprimeve vendosen qëllimet, planifikimi kohor dhe kostoja e përafërt e veprimeve të identifikuara.

**Konsensusi mbi veprimet**

Plani i Veprimeve duhet trajtuar si një marrëveshje shumëpalëshe për të gjetur rrugët më të mira për zgjidhjen e problemeve mjedisore në komunitet. Një proces i suksesshëm për hartimin e Planit të Veprimeve, duhet të sigurojë përfshirjen dhe trajtimin e gjithë mendimeve të individëve të prekur drejtpërsëdrejti apo tërthorazi nga zbatimi i këtyre veprimeve.



Është e rëndësishme që përfaqësuesit e publikut të jenë të mirëinformuar gjatë gjithë procesit të përgatitjes së Planit të Veprimeve, për të siguruar që veprimet e propozuara të reflektojnë prioritetet e tyre. Përfshirja e publikut ndihmon në edukimin e komunitetit lidhur me problemet mjedisore, gjetjen e rrugëzgjidhjeve të mundëshme dhe kostot e veprimeve për zgjidhjet më të përshtatshme.

Pas përgatitjes së Planit të Veprimeve, ai i kalohet Këshillit të Bashkisë / Komunës, për miratimin dhe tërheqjen vëmendjen e tyre. Për të rritur efektivitetin e Planit të Veprimeve, është e rëndësishme që rekomandimet e tij të jenë të lidhura me Planin Zhvillimor të Bashkisë apo Komunës, planet e ndryshme sektoriale dhe buxhetin vjetor.

**Plani i Veprimeve**

| Problemi | Veprimet | Organet | Prioriteti | Kostoja | Efektet |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | 1.1<br>1.2 | | | | |
| | 2.1 | | | | |

PLVM

## Rast Studimor

Tabelë e marrë nga Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për qytetin e Lezhës, në të cilën jepet mënyra e paraqitjes së një Plani Veprimi

| Tematika | Problemi | Aktiviteti | Prioriteti<br>Afati kohor | Burimet financiare<br>Përgjegjësia | Efekti |
|---|---|---|---|---|---|
| **MBROJTJA E NATYRËS**<br>Toka, konvertimi i brigjeve të Drinit, erozioni, shpyllëzimi, gjelbërimi, biodiversiteti, ekosistemet kritike dhe rreziku | Prishja e habitateve në të dy anët e lumit Drin<br><br>*Përshkrimi*<br>Është dëmtuar rëndë brezi me drurë dhe shkurre natyrore në të dy brigjet e lumit Drin dhe është varfëruar Biodiversiteti | Restaurimi dhe përmirësimi i habitatit dhe biodiversitetit në të dy anët e lumit Drin<br><br>*Përshkrimi*<br>Kryerja e studimit për zonën e “mbrojtur nga ndërtimet” dhe për zhvillimin e habitatit, restaurimi me mbjellje dhe harmonizimi me shëtitoren e objektet e tjera urbane. Përcaktimi i bimësisë dhe biodiversitetit që vendoset.<br>Përgatitja dhe zhvillimi i planit të veprimit për këtë qëllim | **3**<br><br>Afat-gjatë | Bashkia<br><br>ARMja<br><br>Donatorët<br><br>OJFtë | Përmirësohen vlerat e trashëguara natyrore të biodiversitetit dhe pejsazhit<br><br>Rriten efektet tërheqëse së qytetit dhe vendet për çlodhje dhe ripërtëritje |

# 6

# ZHVILLIMI I PROJEKTEVE



Vlerësimi i suksesit të një Plani Lokal të Veprimit në Mjedis bëhet duke krahasuar numrin e projekteve konkrete të hartuara mbi bazën e prioriteteve të përcaktuara. Plani i Veprimeve parashikon një listë projektesh/aksionesh për të adresuar çështjet kryesore mjedisore, të cilat prekin komunitetin. Përfaqësuesit vendorë duhet të përqëndrojnë përpjekjet e tyre në shfrytëzimin sa më racional të fondeve të kufizuara që ekzistojnë.

Në përcaktimin e veprimeve duhet të fokusohemi në:

- numrin e projekteve/veprimeve me rezultate afat-shkurtëra dhe afat-gjata;
- efektin shumëdimensional të projekteve/veprimeve plotësues me njëri-tjetrin, që ndihmojnë në përmirësimin e mjedisit dhe arritjen e vizionit tuaj
- projektet e vogla dhe përfituese, të cilat kanë një mundësi të madhe suksesi, si mundësi për grumbullim përvoje në zbatimin e projekteve.

## Udhëzues projekt-propozimi

Projekt-propozimi duhet të jetë një manifestim i detajuar dhe i drejtpërdrejtë i vetë projektit, si mjeti për ta paraqitur në mjedisin e jashtëm sipas një formati lehtësisht të kuptueshëm dhe të pranueshëm

**Titulli i Projektit**

Titulli i projektit duhet të jetë i shkurtër, konçiz dhe pëlqehet t'i referohet ndonjë rezultati 'kyç' dhe specifik, apo ndonjë aktiviteti që udhëheq projektin. Titulli i projektit mund të vihet ne faqen e parë bashkë me të dhënat specifike të projektit si: Institucioni hartues, Personi përgjegjës, Adresa, të dhënat e kontaktit, Agjencinë donatore të cilës i drejtohet projekti, datën.

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

Këtu duhet të bëhet një paraqitje e shkurtër por konçize e të gjithë projektit. Përshkrimi i mundëson lexuesit që t'i gjejnë shpejt pjesët e rëndësishme të dokumentit.

**Qëllimi i projektit**

Qëllimi duhet të shpjegojë thelbin e problemit dhe arsyet që e bëjnë atë të rëndësishëm, p.sh. cilat janë përfitimet afatgjata të grupit në nevojë

**Objektivat e projektit**

Objektivat duhet të adresojnë problemin kryesor dhe të paraqiten si përfitime për grupet në nevojë dhe si rezultate të drejtpërdrejta të projektit

**Rezultatet e projektit**

Rezultatet përbëjnë shërbimet ose produktet që duhen shpërndarë për përfituesit e parashikuar. Kjo pjesë përmban atë çka menaxhimi i projektit premton të realizojë.

**Plani i Aktiviteteve**

Plani i aktiviteteve duhet të përfshijë shpjegime dhe informacione specifike për secilin nga aktivitetet e planifikuara. Gjithashtu, duhet të përcaktohet qartë kohëzgjatja e projektit me të dhëna të hollësishme për datën e fillimit dhe të mbarimit të projektit.

**Buxheti i kërkuar**

Me fjalë të thjeshta, buxheti është një përmbledhje e kategorizuar e të ardhurave që pret institucioni në një periudhë të caktuar kohore. Është e rëndësishme që financierët të përpilojnë buxhete të cilat përputhen qartësisht dhe me përpikmëri me kërkesat e organizatës financuese, për buxhetimin dhe raportimin e shpenzimeve. Dy elementët kryesorë të buxhetit janë: të ardhurat dhe shpenzimet.

**Treguesit e suksesit të projektit**

Këto elemente të plan-projektit, "përkthejnë" qëllimin e projektit dhe rezultatet e tij, në njësi të matshme (sasiore dhe cilësore), ndaj përbëjnë bazën për të matur shkallën e ndikimit

**Grupi i punës**

# Projekte të financuara nga REC Shqipëri

**Titulli i projektit "Të gjithë së bashku për të ndihmuar vetëveten"**
**OJF: Shoqata e Mbrojtjes dhe Ruajtjes së Mjedisit Natyror Shkodër**
**Përmbledhje e projektit:** Futja e metodave të reja për trajtimin e mbeturinave (ndarja e tyre në familje) për banorët e një zone pilot në Shkodër. Aktivitete pastrimi me pjesëmarrjen e banorëve të zonës, nxënësve të shkollave në bashkëpunim me ndërmarrjen e pastrim-gjelbërimit të qytetit. Takime me banorët dhe një mbledhje e hapur në fund të projektit.

**Titulli i projektit: "Hartimi i një manuali për menaxhimin e mbeturinave të ngurta"**
**OJF:** Fondacioni "Integrimi Urban"
**Përmbledhje e projektit:** Projekti parashikon hartmin e një udhëzuesi për mirëmenaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane. Materiali i botuar në formën e një broshure do të prezantohet në një takim trajnues me përfaqësues të qevrisjes vendore.



**Titulli i projektit:** Rehabilitimi i zonave të gjelbra në Elbasan
**OJF:** Forum i Pavarur i Gruas – Elbasan
**Përmbledhje e projektit:** Punime rehabilitimi për zonat e gjelbra në Elbasan. Një numër aktivitetesh për rigjallërimin e traditave qytetare për pastrimin e hapësirës përreth banesave. Organizimi i një fushate në media. I gjithë aktiviteti i projektit do të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me bashkinë e qytetit.

**Titulli i projektit: Për një mjedis më të pastër**
**OJF:** Klubi Ambjentalist Kurbin
**Përmbledhje e projektit:** Projekti synon të përmirësojë cilësinë e mjedisit në qytetin e Laçit. OJF-ja parashikon që në bashkëpunim me ndërmarrjen e pastrim gjelbërimit të bashkisë së qytetit të ndërtojë pika grumbullimi të mbeturinave në qytet, për të cilat do të kujdeset në vijim ndërmarrja e bashkisë. Ky aktivitet konkret do të shoqërohet me aktivitete ndërgjejgësuese për banorët në lidhje me trajtimin e mbeturinave të ngurta familjare.



**Titulli i projektit:** Të punojmë së bashku për një mirëmenaxhim të mbeturinave urbane
**OJF: Shoqata e Mbrojtjes dhe ruajtjes së Mjedisit Natyror**
**Përmbledhje e projektit:** Projekti synon ngritjen e nivelit të ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut në lidhje me mbeturinat e ngurta, futjen e koncepteve të tjera dhe nxitjen e bashkëpunimit me organet e qeverisjes vendore. Njëkohësisht do të përgatiten dhe vendosen në dy rrugë kryesore kosha të vegjël mbeturinash për të shmangur hedhjen e mbeturinave në rrugë. Në kohën e vendosjes së këtyre koshave do të organizohen dhe aktivitete konkrete pastrimi me banorët e zonës.

# 7

# MONITORIMI DHE VLERËSIMI



Një monitorim dhe vlerësim efektiv parashtron një rrjedhë të qëndrueshme informacioni, e cila konsolidon zbatimin e projektit. Procesi i monitorimit dhe vlerësimit parashikon një mundësi për të:

- krahasuar përpjekjet për zbatim me qëllimet dhe objektivat origjinale;
- përcaktuar nëse progresi i mjaftueshëm është bërë drejt arritjes së rezultateve të pritshme;
- përcaktuar nëse ju i keni qëndruar besnik programit kohor të projektit.

Monitorimi dhe vlerësimi nuk është një "ngjarje", e cila ndodh në fund të projektit, por është një proces i vazhdueshëm, i cili ndihmon vendim-marrësit të kuptojnë efektshmërinë e një projekti apo veprimi. Ky proces zakonisht përfshin grumbullimin e të dhënave për kushtet ekzistuese, raportimin për progresin drejt përmirësimit të mjedisit, krijimin e lidhjes ndërmjet veprimeve dhe rezultateve të pritshme. Një proces monitorimi dhe vlerësimi i mirë angazhon të gjithë aktorët dhe është i dobishëm së fundmi për ata që janë përgjegjës për të përmirësuar projektin. Vlerësimi mund të shihet si një mjet për të mësuar për menaxherët dhe pjesëmarrësit në projekt, si dhe një mjet i rëndësishëm për ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut.

Grupi i aktorëve ose bashkia/komuna duhet të konsiderojë këtë asemble një ekip monitorimi dhe vlerësimi, për të ndihmuar në mënyrën e vlerësimin dhe për të vlerësuar rezultatet e projektit. Ekipi mund të përbëhet nga individë me njohuri në vlerësimin e projektit, institucione përgjegjëse për sigurimin e të dhënave mjedisore dhe institucione zbatuese, si industritë me kërkesa specifike mjedisore.

| Format për vlerësim projekti |
|---|
| **Përmbledhje e rezultateve** |
| **Përshkrimi i projektit**<br>Rishikim i historisë së projektit, institucionet pjesëmarrëse, ekipi vlerësues, qëllimet dhe synimet |
| **Informacion për grumbullimin e të dhënave**<br>Indikatorët e zgjedhur, kërkesat për raportim dhe metodat e grumbullimit të të dhënave |
| • **Rezultatet**<br>Ndikimet Sasiore:<br>Sa mirë janë arritur synimet e vëna dhe përmirësimet mjedisore? A janë mbajtur afatet? A u mirëpërdor buxheti? |
| • **Ndikimet cilësore:**<br>A janë të kënaqur përfituesit e projektit? A kishte ndonjë përfitim të paparashikuar përtej qëllimeve origjinale? |
| • **Ndikimet edukative:**<br>A janë arritur njohuritë dhe aftësitë e duhura? A janë ndryshuar apo riforcuar qëndrimet? |
| **Vështirësitë e hasura:**<br>Probleme të brendëshme (p.sh. institucionale) dhe të jashtme të hasura gjatë zbatimit. |
| **Mësime të dala:**<br>Analiza e njohurive të fituara si rezultat i rekomandimeve të projektit për përjekjet e ardhshme në zbatim. |

# 8

# ORGANIZIMI I TAKIMEVE ME PUBLIKUN





Marrja e mendimit të publikut konsiston në informimin e tij dhe identifikimin e vizionit të anëtarëve të komunitetit. Në përgatitjen e një Plani Lokal të Veprimit në Mjedis, marrja e mendimit të publikut ka të bëjë me edukimin e publikut lidhur me qëllimin e PLVMsë, sigurimin e informacionit për llojshmërinë e problemeve mjedisore dhe ndarjen e ideve në zbatimin e aktiviteteve.



Ky proces i siguron banorëve informacionin se çfarë ata mund të bëjnë veëamas dhe së bashku për të përmirësuar cilësinë e mjedisit në komunitetin e tyre, si p.sh. si të riciklojmë mbeturinat, si të ulim konsumin e ujit, etj.



Një fushatë marrjesh medimi me publikun kërkon dy rrugë komunikimi. Kështu, është e rëndësishme që grupi i punës të marrë në konsideratë interesimin e publikut për të siguruar që prioritet dhe zgjidhjet që ju keni gjetur të shprehin ato të publikut.



Për të marrë pjesë, qytetarët duhet të kenë mënyra lehtësuese për të kontribuar. Ata duhet të jenë të informuar se si mendimet e tyre janë shprehur në mendimin përfundimtar. Edukimi i publikut nuk është synimi përfundimtar, por ai është një mënyrë për rritjen e zërit të tij në proceset e vendim-marrjeje.